



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**VENDIM
PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESAVE ANKIMORE NR.10, PARAQITUR NË
KQZ NË DATËN
29.05.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 30.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKTI: Për mospranimin për shqyrtim kërkesës ankimore Nr.10, datë 29.05.2019, të paraqitur nga subjekti ankues Partia Demokracia e Re Europiane me objekt: Kundërshtimi i vendimit nr.22, datë 21.05.2019 të KZAZ-së nr.17 "Për mos regjistrimin e listës shumëmerore për këshillin e Bashkisë Klos;

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 129, pika 1, 3, germa "b" dhe nenin 130 germa "c" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Subjekti zgjedhor Partia Demokracia e Re Europiane ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e Ankimeve Zgjedhore, me nr. 10 regj, datë 29.05.2019.



Nr. 735 i Vendimit

Data 30.05.2019

Ora 17:00 e Vendimit

Për mos pranimin për shqyrtim të kërkesave ankimore nr. 10 të paraqitur në KQZ në datën
29.05.2019

Në mbledhjen e datës 30.05.2019, ora 17:00 pas relatimit të znj. Rezarta Bitri, dhe diskutimit të përfaqësuesve të partive politike kërkesa nr.10 u konstatua se kërkesa ankimore nuk i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 dhe në mbështetje të nenit 129 pika 1, 3, germa "b", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Kërkesa Ankimore nuk duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 129, pika 1, 3, germa "b" dhe nenin 130 germa "c" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.10, datë 29.05.2019, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Demokracia e Re Europiane.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

